



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUČITRN

01 Nr. / Br 179/13

Nr. i fq. / Br. sht -1-

Data / Datum 25.07.2013

VUSHTRRI - VUČITRN



**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës- Vushtrri**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më **25.07.2013**, pas shqyrtimit të Draft-Rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për territorin e Komunës së Vushtrrisë për vitin 2014, duke u bazuar në nenin 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neni 12 të Statutit të Komunës, nenit 7-të të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/09 për transparencë nëpër komuna, si dhe nenit 2 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013, mori këtë:

## **V E N D I M**

### **Neni 1**

Ipet në diskutim publik Draft-Rregullorja për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për territorin e Komunës së Vushtrrisë për vitin 2014.

### **Neni 2**

Diskutimi publik fillon nga data 26.07.2013 dhe zgjatë deri më 26.08.2013.

### **Neni 3**

Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmer masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna, dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

### **Neni 4**

Obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që si hartues dhe propozues i Draft-rregullores në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 2008/09, dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

Gjithashtu DBF-ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-rregullores në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin Shtator 2013.

### **Neni 5**

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.

**Kryesuesi i Kuvendit**



**Habib Mustafa**



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIK - KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPSTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 180/13

Nr. i fq. / Br. sh -1-

Data: / Datum 25.07.2013

VUSHTRRI - VUÇITRN



**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës- Vushtrri**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më **25.07.2013**, pas shqyrtimit të Draft-Rregullores për Rregullat dhe Procedurat e Ndërtimit të Objekteve në territorin e Komunës së Vushtrrisë, duke u bazuar në nenin 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neni 12 të Statutit të Komunës, nenit 7-të të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/09 për transparencë nëpër komuna, si dhe nenit 2 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013, mori këtë:

### **V E N D I M**

#### **Neni 1**

Ipet në diskutim publik Draft-Rregullorja për Rregullat dhe Procedurat e Ndërtimit të Objekteve në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

#### **Neni 2**

Diskutimi publik fillon nga data 26.07.2013 dhe zgjatë deri më 26.08.2013.

#### **Neni 3**

Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna dhe nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

#### **Neni 4**

Obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që si hartues dhe propozues i Draft-rregullores në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 2008/09, dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

Gjithashtu DUMM-ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-rregullores në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin Shtator 2013.


#### **Neni 5**

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.

**Kryesuesi i Kuvendit**



**Habib Mustafa**



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Në bazë të nenit 12.2 "d" dhe nenit 14.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nenit 41.2 "ç" të Statutit të Komunës dhe nenit 11.4 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nr.04/L-144, si dhe në bazë të Raportit të vlerësimit të Ministrisë së Financave, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më 25.07.2013, mori këtë:

## V E N D I M PËR KËMBIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME KOMUNALE

### Neni 1

Me këtë vendim Komuna e Vushtrrisë bën këmbimin e pronës së paluajtshme **Nr.P-70202016-00605/1**, e cila është e regjistruar në certifikatën e pronësisë: **UL-70202016-00045** në sipërfaqe prej 98 m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale Vushtrri (e cila gjendet në rr. "Dëshmorët e Kombit" (përballë objektit të Gjykatës), me parcelën **Nr.P-70202016-00691/2**, pronë e z. Ruzhdi Ukiqi nga Vushtrria, e cila është e regjistruar në certifikatën e pronësisë: **UL-70202016-02933**, në sipërfaqe prej 88 m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale Vushtrri (e cila gjendet në ish tregun e qytetit-afër objektit të komunës).

### Neni 2

2.1. Obligohet z.Ruzhdi Ukiqi-pronar i paluajtshmërisë nr.691/2 që t'ia kompensoj Komunës së Vushtrrisë diferencën e vlerës së paluajtshmërisë në shumë prej: 37,800.00 € (tridhjeteshtatë mijë e tetëqind euro), duke e ndarë në tri rata në shumë proporcionale:  
2.1.1. Rata e parë në afat prej 15 ditësh prej ditës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi;  
2.1.2. Rata e dytë në afat prej 3 muaj prej pagesës së ratës së parë dhe  
2.1.3. Rata e tretë në afat prej 3 muaj prej pagesës së ratës së dytë.

### Neni 3

Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë që pas kompensimit të vlerës (diferencës) si në nenin 2 të këtij vendimi nga z.Ruzhdi Ukiqi të bën regjistrimin në RDPP të parcelës nr.605/1 në emër të z. Ruzhdi Ukiqi, kurse parcelën nr.691/2 ta regjistron në emër të Komunës së Vushtrrisë.

### Neni 4

4.1. Obligohet Kryetari i Komunës që të menaxhon të gjithë procedurën e ekzekutimit deri në zbatimin final të këtij vendimi.  
4.2. Obligohet Kryetari i Komunës që lidhur me zbatimin e këtij vendimi çdo tre muaj ta informon Kuvendin e Komunës deri në zbatimin final të vendimit.

### Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit  
  
Habib Mustafa





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUÇITRN	
01 Nr./Br	182/13
Nr. i fq./ Br. st	-1-
Data / Datum	25.07.2013
VUSHTRRI - VUÇITRN	



**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës- Vushtrri**

Në bazë të nenit 17 "o" dhe 40.2 "i" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, dhe nenit 40.2 "h" dhe 41.2 "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, si dhe në bazë të propozim-listës së paraqitur nga Komisioni për propozimin e emërtimit të rrugëve dhe shesheve në territorin e Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **25.07.2013**, mori këtë:

### **V E N D I M**

#### **PËR APROVIMIN E LISTËS PËR EMËRTIMIN E RRUGËVE DHE SHESHEVE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË VUSHTRRISË**

##### **Neni 1**

Me këtë vendim aprohet lista e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

##### **Neni 2**

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, si dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

##### **Neni 3**

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Kryesuesi i Kuvendit**  
  
**Habib Mustafa**





REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 182-1/13

Nr. i fq. / Br. st -1-

Data: / Datum 25.07.2013

VUSHTRRI - VUÇITRN



**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës- Vushtrri**

Në bazë të nenit 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, dhe nenit 41.2 "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, si dhe në bazë të propozimit për kompensim të paraqitur nga Komisioni për emërtimin të rrugëve dhe shesheve në territorin e Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **25.07.2013**, mori këtë:

### **V E N D I M**

#### **PËR KOMPENSIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT PËR EMËRTIMIN E RRUGËVE DHE SHESHEVE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË VUSHTRRIË**

##### **Neni 1**

Me këtë vendim bëhet kompensimi për anëtarët e komisionit për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

##### **Neni 2**

**2.1.** Komisioni për emërtimin e rrugëve dhe shesheve për punën e tij kompensohet prej mallrave dhe shërbimeve nga Drejtoria për Shërbime Publike.

**2.2.** Shuma e kompensimit për çdo anëtar të komisionit është 300 € (treqind euro), kurse totali i kompensimit për të gjithë anëtarët e komisionit është 7.500 € (shtatë mijë e pesëqind euro).

##### **Neni 3**

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Shërbime Publike dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

##### **Neni 4**

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Kryesuesi i Kuvendit**



*Habib Mustafa*  
**Habib Mustafa**



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 183/13

Nr. i fq. / Br. sht -1-

Data / Datum 25.07.2013

VUSHTRRI - VUÇITRN



**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës- Vushtrri**

Në bazë të nenit 12.1 dhe 51.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 41.2 "ç" dhe nenit 54.4 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **25.07.2013**, mori këtë:

## **V E N D I M**

### **Neni 1**

**1.1.** Me këtë vendim emërohen anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF-së) në Vushtrri:

- 1.1.1.** Selim Rrustemi (PDK);
- 1.1.2.** Nasuf Aliu (AKR).

### **Neni 2**

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Sekretaria e Kuvendit.

### **Neni 3**

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.

**Kryesuesi i Kuvendit**  
  
**Habib Mustafa**

